

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Ishiteve / Izlazeve / Date / Datum: 06.08.2024		
Nr. Orgj. Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 69	Nr. Faqeve. Br. Strana. 1
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 64
Data: 31.07.2024

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 i datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datën 31.07.2024 miratoi këtë:

**VENDIM
PËR APROVIMIN E STATUTIT AKTUAL TË QKMF-SË TË VITIT 2016 SI DHE
DRAFT-STATUTIT UNIK TË QKMF-SË TË ADAPTUAR ME SPECIFIKA TË QKMF-
SË NË KOMUNËN E FERIZAJT.**

I

Me këtë Vendim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Ferizajt me Nr:213/24 i datës 10.09.2024 për aprovimin e Statutit aktual të QKMF-së të Vitit 2016 si dhe Draft-Statutit Unik të QKMF-së të adaptuar me specifika të QKMF-së në Komunën e Ferizajt.

II

Ky Statut ka për qëllim rregullimin e dispozitave të përgjithshme, emërtimin dhe selia, veprimtaria e QKMF-së, Statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e institucionit, udhëheqja dhe trupat e institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm institucional, mbikqyrja e QKMF-së, aktet e përgjithshme të QKMF-së, pronësia dhe financimi, transparenca në punë, konfidenca profesionale dhe afariste.

III

Pjesë përbërse e këtij vendimi është edhe materiali i detajuar i Statutit të QKMF-së.

IV

Për këtë vendim do të përkujdeset Drejtoria e Shëndetësisë si dhe Kuvendi i Komunës së Ferizajt.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
- EJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Ishje: Izlaze: Date / Dana: 06.08.2024		
Nr. Urgj. / Urg. jed: 01	Nr. Prot. / Br. Prot.: 65	Nr. Faqeve. / Br. Strana: 1



FERIZAJ - UROŠEVAC
REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

**KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY**

**01.Nr. 65
Data: 31.07. 2024**

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale Nr:03/L-040 si dhe në bazë të nenit 51 paragrafi 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt Nr. 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2024 miratoi këtë:

**VENDIM
PËR APROVIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL TË
KOMUNËS SË FERIZAJT PËR PERIU DHËN KOHORE 2024-2034**

I

Aprovohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Ferizajt me Nr. 214/2024 i datës 12.07.2024 për Aprovimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Ferizajt për periudhën kohore 2024-2034

II

Përmes kësaj strategjie synohet që përgjatë viteve në vijim të krijohen politika efektive në favor të zhvillimit ekonomik dhe rritjes së qëndrueshmërisë në periudhën kohore 2024-2034.

III

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe dokumenti i Strategjisë së lartë cekur.

IV

Për këtë vendim do të përkujdeset Drejtoria për Zhvillim Ekonomik si dhe Kuvendi i Komunës.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
UREJTORIA E ADMINISTRATËS DHË PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalese / Izlazne: Date / Dana: 06.10.2024		
Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 66	Nr. Faqeve. Br. Strana. 2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 66
Data: 31.07. 2024

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 3, pika 1.12, neni 4, neni 5, neni 6, pika 1.2, neni 7, pika 1, neni 8 pika 1.2 e Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 4, neni 5, pika 1.3, neni 15 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës të nenit 51 të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2024 miratoi këtë:

**VENDIM
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PJESËS SË NGASTRËS
KADASTRALE 626-2 Z.K.BABUSHI I RI.**

I

I ipet në shfrytëzim afatgjatë pjesa e ngastrës kadastrale 626-2 Z.K.Babush i Ri me sipërfaqe prej 504 m² (5 ari e 4 m²) subjekti juridik "IDEALI" SH.P.K. me numër identifikues 810045189, përfaqësuar nga Real Arifi me Nr. 1242138097 aksionar 100% i subjektit juridik.

II

Vlera e investimit sipas projektit është 50,000.00€ e planifikuar për periudhën 13 vjeçare. Numri i të punësuarve nga investimi 4-5 brenda 10 viteve. Lloji i investimit – Veprimtaria kultivim i dheut për lule, rritje e drunjëve dekorativ, luleve dhe material përcjellëse.

III

Çmimi i qirasë është 100.00€ për një vit kalendarik dhe fillon të faturohet nga data e nënshkrimit të kontratës.

IV

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur më lartë është zhvillim ekonomik.

V

Procesi me të cilin është zhvilluar procedura është dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës komunale e është përmes shprehjes së interesit.

VI

Përfituesi i pronës së lartë cekur është i obliguar që të implementojë projektin me të cilin ka fituar të drejtën e shfrytëzimit, nuk lejohet ndryshimi i veprimtarisë për të cilën është fituar e drejta e shfrytëzimit të parcelës kadastrale, nuk ka të drejtë ta lëshoj pronën me qira, ta vendos në hipotekë, nuk ka të drejtë ta bartë te persona tjerë, nuk lejohet ndryshimi i aksionarit për njësinë e fituar sipas këtij projekti.

VII

Prona e dhënë në shfrytëzim nuk mund të shfrytëzohet si mbulesë për pagimin e obligimeve nëse subjekti fitues falimenton, pra nuk mund të jetë objekt i shitjes nëse subjekti përfitues e shpall falimentimin, qoftë në mënyrë vullnetare apo përmes Gjykatës.

VIII

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim është mbështetja dhe fuqizimi i bizneseve lokale dhe përmes kësaj Komuna e Ferizajt synon që të rrisë zhvillimin ekonomik duke krijuar mundësi për hapje të vendeve të punës dhe krijimit të hapësirës për zhvillim të bizneseve vendore.

IX

Për këtë vendim kujdeset Kryetari i Komunës si dhe Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër.

X

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi

020-514/6
-VI- 02.09.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajit Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajit	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erbilin Hetemi, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë 09/08/2024 Nr. 020-514
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligshmërisë e aktit të komunës së Ferizajit	
Lloji i aktit:	Vendimit	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullore (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim nr. 66 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrës kadastrale 626-2 z.k Babush i Ri"
I miratuar më datë: 31.07.2024
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.08.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Ferizajit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2024, ka miratuar vendimin nr. 66 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrës kadastrale 626-2 z.k Babush i Ri”.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Ferizajit është i bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale neni 12, Ligjin Nr.06/L-92 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nenin 3 paragrafi 1.12 neni 5, nenin 8 paragrafi 2 dhe neni 19.

Vendimi nr. 66 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pjesës së ngastrës kadastrale 626-2 z.k Babush i Ri” është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Ferizajit me datë 31.07.2024, me 23 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim. Ipet në shfrytëzim ngastra e lartcekur subjektit juridik Idela SH.P.K në sipërfaqe prej 504^{m2} me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë *“kultivimin e dheut për lule, rritjen e drunjëve dekorativ, luleve dhe materialëve përcjellëse”*.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Lokale: Izlazne: Date / Dana: 06.10.2024

Nr. Orgv Org. jed.	Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Faqeve. Br. Strana.
01	63	2

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 63
Data: 31.07. 2024

Në bazë të nenit 12 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në bazë të nenit 51 paragrafi 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2024 miratoi këtë:

VENDIM
PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT 01.NR.33 I DATËS 30.04.2024

I

Me këtë vendim plotësohet vendimi i datës 30.04.2024 me numër 01.Nr.33, dhe atë i shtohen këta anëtar/e:

1. Qendra Sociale Swok Kosova- Besnik Rrustemi
2. Kuvendi i të rinjëve të Ferizajt – Jeronim Sabedini
3. Klubi Rin-on – Granit Sadiku
4. Rrjeti i ojq-ve Avonet- Kenan Gashi
5. Zyra e informimit – Shyhrete Topalli
6. Drejtoria e Financave – Fisnik Sylajemani
7. Zyra e Kuvendit – Leutrim Mahmuti (sekretar)
8. Handikos Ferizaj – Enver Kosumi
9. Doën Syndrom Kosova – Gresa Behluli
10. Hendifer – Gojarta Grainca
11. Drejtora e Zhvillimit Ekonomik – Endrita Shabani
12. Drejtoria e Arsimit – Flodian Maloku

II

Të gjitha pikat tjera të vendimit 01.Nr.33 i datës 30.04.2024 mbesin në fuqi.

III

Për këtë vendim do të kujdeset Kuvendi i Komunës.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Udhëzime / Izlazine: Date / Dana: 06.08.2024

Nr. Orgv. Org. jed.	01	Nr. Prot. Br. Prot.	68	Nr. Faqeve. Br. Strana.	1
------------------------	----	------------------------	----	----------------------------	---

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 68
Data: 31.07.2024

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt Nr.L-01.Nr.50 të datës 28.06.2013. Kuvendi i Komunës në mbledhje e mbajtur me datë 31.07.2024 miratoi këtë:

VENDIM

PËR RISHQYRTIMIN E VENDIMIT ME NR: 01.NR.52 TË DATËS 30.05.2024

I

Rishqyrtohet Vendimi me Nr. 01.Nr.52 i datës 30.05.2024, ashtu që plotësohet Raporti i Komisionit për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta e parablerjes me Nr.01.Nr.463-186 i datës 09.07.2024 sipas rekomandimeve të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

II

Pikat tjera të Vendimit Nr.52 i datës 30.05.2024 të cilat nuk preken nga ky vendim mbesin në fuqi.

III

Pjesë e këtij Vendimi është edhe Raporti i komisionit të lartë cekur në nenin I të këtij vendimi.

IV

Për këtë vendim kujdeset Kryetari i Komunës së Ferizajt si dhe Drejtorja për Pronë Gjodezi dhe Kadastër.

V

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	02	5182-2/24
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture	02	22.08.24
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure		
PRISHTINE / A		

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt Xhavit Zariqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Ferizajt	
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI	
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor	Datë: 14.08.2024 Nr. VL 142/24
Zyrtarët përgjegjës:	1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Shendrita Latifi - zyrtare ligjore në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit	
Lloji i aktit:	Ligjshmëria e aktit Vendim për rishqyrtimin e vendimit me Nr. 01.Nr.52 të datës 30.05.2024, miratuar nga Kuvendi Komunal i Ferizajt, datë 31.07.2024	

I nderuar kryetar Aliu,
I nderuar kryesues Zariqi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, më datë 12.08.2024 ka pranuar nga MAPL Vendimin për rishqyrtimin e vendimit me Nr. 01.Nr.52 të datës 30.05.2024, miratuar nga Kuvendi Komunal i Ferizajt, datë 31.07.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave:

KONFIRMON

Vendimin për rishqyrtimin e vendimit me Nr.01. Nr.52 të datës 30.05.2024, miratuar nga Kuvendi Komunal i Ferizajt, datë 31.07.2024.

ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur konstatoi se:

Vendimi është i bazuar në Ligjin Nr.08/L-011 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.04/L-247. Gjithashtu, në raport ka të inkorporuar informatat e kërkuara sipas Legjislacionit në fuqi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës mbetet në dispozicion të Komunës së Ferizajt dhe MAPL-së për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT - OPŠTINA UROŠEVAC - MUNICIPALITY OF FERIZAJ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT - UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA

Shprehje: Izlazne, Date/Dana: 06.08.2024

Nr. Orgv Org. jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 69	Nr. Faqeve. Br. Strana. 1
--------------------------	---------------------------	------------------------------

Ferizaj - Uroševac



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 69
Data: 31.07.2024

Në bazë të nenit 12 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës së Ferizajt i datës 28.06.2013 me Nr. 01.Nr.50 si dhe nenit 6 pika 1.3 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 31.07.2024 miratoi këtë:

VENDIM

PËR BARTJEN E ASETIT (FABRIKËS SË UJIT) NË TALINOVC TË MUHAXHERËVE, KOMPANISË RAJONALE TË UJËSJELLËSIT "BIFURKACIONI"

I

Aseti (objekti i fabrikës së ujit) i cili gjindet në ngastrën kadastrale 00992-0 Z.K.Talinoc i Muhaxherëve pronë e Komunës së Ferizajt me sipërfaqe prej 1630 m² i ipet në shfrytëzim K.R.U. "Bifurkacioni" në afat kohorë prej 99 viteve për prodhimin e ujit të pijshëm.

II

Obligohet Drejtoria për Pronë dhe Kadastër që të bëjë matjen e pikave gjeodezike dhe të njejtin ta regjistrojë në libra kadastral.


III

Për këtë Vendim do të kujdeset Kuvendi i Komunës së Ferizajt si dhe Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër.


IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajit Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Ferizajit
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, U.D. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erbllin Hetemi, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave
Lënda:	Kërkesë për shqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Ferizajit
Lloji i aktit:	Vendimit

Datë
13/08/2024
Nr. 020-514

I nderuar Kryetar,
I nderuara Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 69 për bartjen e astetit në Talinoc të Muhaxherëve kompanisë rajonale të ujësjellësit "Bifurkacioni"
I miratuar më datë: 31.07.2024
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.08.2024

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit vlerëson se akti është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës të Ferizajit me datën 31.07.2024 ka miratuar vendimin Nr. 69 për bartjen e astetit në T'alinoc të Muhaxherëve kompanisë rajonale të ujësjellësit "Bifurkacioni". Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me të pranuar aktin e miratuar nga Kuvendi i Komunës të Ferizajit ka ndërmarr veprime bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale për shqyrtim të ligjshmërisë.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale neni 81 "shqyrtimin e detyrshëm të ligjshmërisë" konstaton se:

Premabula, titulli dhe neni një (1) i vendimit Nr. 69 përcaktojnë tri çështje dhe si të tilla janë në kundërshtim me LIGJIN NR. 06/L-092 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS. Në rastin konkret "dhënia e pronës së paluajtshme për me pak se një (1) vit" bazën ligjore në të cilën referohet vendimi, "bartja e astetit" emërtim i aktit dhënie në shfrytëzim e pronës në afat kohorë prej "nëntëdhjetë e nëntë (99) vite" nuk mund të trajtohen në një vendim për faktin se janë proceduar dhe forma të ndryshme lidhur me pronën e paluajtshme komunale.

Komunat mund të japin në shfrytëzim pronën e paluajtshme me pak se një (1) vit por procedurat, format për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës rregullohen dhe përcaktohen me rregullore komunale ashtu si njihet kjo e drejtë me LIGJIN NR. 06/L-092 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS nenin 6 paragrafi 1.

Komunat mund të bëjnë bartjen e pronës publike dhe formave tjera duke u bazuar në LIGJIN NR. 08/L-125 PËR PRONËN PUBLIKE neni 14 "bartja e paluajtshmërive në pronësi publike për realizimin e interesit publik, transferimi i së drejtës pronësore përmes këmbimit, dhënia me qira, dhënia me koncesion dhe partneriteti publiko-privat, eksploatimi i resurseve natyrore dhe minerale në bazë të licencës, investimi monetar në letra me vlerë, patundshmëri dhe format e tjera të investimit kapital me qëllim përfitimi dhe donacioni dhe subvencioni i sendeve të luajtshme/ni njëteve monetare".

Ndërsa dhënie e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë nga komunat deri nëntëdhjetë e nëntë (99) vite përmes shprehjes së interesit është e përcaktuar në LIGJIN NR. 06/L-092 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS përkatësishit nenin 3 paragrafi 1.12 ku "nënkupton procesin e konkurrencës së hapur ku fituesi zgjidhet në bazë të kritereve të specifikuar në thirrjen për ofertë".

Ministria e Admsinitimit të Pushtetit Lokal bazuar në të lartcekurat kërkon nga Kuvendi i Komunës të Ferizajit që të ndërmarrin veprime dhe brenda afatit ligjor të rishqyrtojë aktin dhe të harmonizojë me legjisacionin në fuqi.